



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 272/ 4 Prot.,

Datë 25.02.2022

V E N D I M
Nr. 197/2022

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaïd Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 25.02.2022, shqyrtoi çështjen me:

Objekt:

Vendim për mbylljen e çështjes mbi ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “*Erisoni Company*” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur*”, me Nr. REF-00443-07-07-2021, me objekt “*Blerje Tonera e ndarë në 8 (tetë) lote*”, me Fondi limit/vlera e pritshme e kontratës: 259,114,090 (dyqind e pesëdhjetë nëntë milionë e njëqind e katërbëdhjetë mijë e nëntëdhjetë) Lekë pa TVSH ose 2,113,147 € (dy milionë e njëqind e trembëdhjetë mijë e njëqind e dyzetë e shtatë) Euro pa TVSH. Kursi i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë i datës 01.07.2021 është 122.62 Lekë. **Loti 6** me Nr. REF-00456-07-07-2021, me objekt “*Blerje Tonerë për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë*” me fond limit *11,190,161* lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 09.08.2021 nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Blerjeve të Përqendruara.

Ankimues:

“*Erisoni Company*” SHPK
Adresa: Rruga “*Shoqëria Bashkimi*”, Lagjja 6, Durrës.

Autoriteti Kontraktor:

Agjencia e Blerjeve të Përqendruara
Adresa: Bulevardi “*Dëshmorët e Kombit*”, Nd. 1, 1001, Tiranë.

Baza Ligjore:

Nenet 30 dhe 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi informacionin e paraqitur,

Vëren:**I***Vlerësimi Paraprak*

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II*Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 08.07.2021 në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, është publikuar procedura e prokurimit “Procedurë e Hapur”, me Nr. REF-00443-07-07-2021, me objekt “Blerje Tонера” e ndarë në 8 (tetë) lote”, me Fondi limit/vlera e pritshme e kontratës: 259,114,090 (dyqind e pesëdhjetë nëntë milionë e njëqind e katërbëdhjetë mijë e nëntëdhjetë) Lekë pa TVSH ose 2,113,147 € (dy milionë e njëqind e trembëdhjetë mijë e njëqind e dyzetë e shtatë) Euro pa TVSH. Kursi i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë i datës 01.07.2021 është 122.62 Lekë. **Për Loti 6** me Nr. REF-00456-07-07-2021, me objekt “Blerje Tonerë për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë” me fond limit 11,190,161 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 09.08.2021 nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Blerjeve të Përqendruara.

II.2. Në datën 15.10.2021 autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

II.3. Në datë 11.01.2022, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr. 27/2022, ku vendosi:

1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Erisoni Company” SHPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur”, me Nr. REF-00443-07-07-2021, me objekt “Blerje Tонера” e ndarë në 8 (tetë) lote”, me Fondi limit/vlera e pritshme e kontratës: 259,114,090 Lekë pa TVSH ose 2,113,147 Euro pa TVSH. Kursi i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë i datës 01.07.2021 është 122.62 Lekë, Loti 6 me Nr. REF-00456-07-07-2021, me objekt “Blerje Tonerë për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë” me fond limit 11,190,161 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 09.08.2021 nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Blerjeve të Përqendruara.
2. Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Infosoft Office” SHPK për procedurën e prokurimit më sipërcituar.
3. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “IT Gjergji Kompjuter” SHPK për procedurën e prokurimit më sipërcituar.
4. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së mbi skualifikimin e operatorëve ekonomikë “Erisoni Company” SHPK dhe “Infosoft Office” SHPK, si dhe të korrigjojë shkeljet, duke i kualifikuar këta operatorë ekonomikë.
5. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
- 6.
7. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatorët ekonomikë “Erisoni Company” SHPK dhe “Infosoft Office” SHPK.
8. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit të tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “IT Gjergji Kompjuter” SHPK.
9. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
10. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

II.4. Në datën 17.01.2022 autoriteti kontraktor ka kryer rivlerësimin e procedurës së prokurimit dhe në datën 03.02.2022, operatorët ekonomikë pjesëmarrës janë njoftuar elektronikisht mbi klasifikimin përfundimtar të ofertave si vijon:

- “Marketing & Distribution” SHPK	2,813,646	lekë	skualifikuar
- “InfoSoft Office” SHPK	4,456,139	lekë	skualifikuar
- “IT Gjergji Kompjuter” SHPK	6,166,275.44	lekë	skualifikuar
- “Erisoni Company” SHPK	8,628,460	lekë	kualifikuar

II.4. Në datën 07.02.2022 autoriteti kontraktor, ka kryer Publikimin e Njoftim-Anulimit në sistemin e prokurimeve elektronike si dhe publikuar në Buletinin e Njoftimeve Publike nr. 19, me datë 14.02.2022.

II.5. Referuar materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ, rezulton se në datën 14.02.2022, operatori ekonomik “*Erisoni Company*” SHPK, ka paraqitur ankesën pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, duke kërkuar shfuqizimin e vendimit të autoritetit kontraktor për anulimin e procedurës së prokurimit.

II.6. Në përputhje me nenin 112 “*Veprimet paraprake*” të Ligjit nr.162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe me anë të formularit të publikimit nr. 272/2 prot., datë 15.02.2022, janë publikuar pretendimet e ngritura nga ankimuesi.

II.7. Me shkresën nr. 257/2 prot, datë 21.02.2022, protokolluar me tonën me nr. 272/3 prot., datë 23.02.2022 është dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, vendimi i autoritetit kontraktor lidhur me trajtimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik “*Erisoni Company*” SHPK, për procedurën e mësipërme të prokurimit, në të cilën është vendosur **pranimi i ankesës** së bërë nga operatori ekonomik ankimues.

Konkretisht, autoriteti kontraktor në vendimin e sipërcituar ka arsyetuar si më poshtë:

“Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, në zbatim të vendimit të KPP, ka bërë rivlerësimin në sistemin e prokurimit elektronik si dhe në formë shkresore nëpërmjet procesverbalit nr. 3, “Për ri-vlerësimin e ofertave”, datë 17.01.2022 duke ri-kualifikuar operatorin ekonomik “Erisoni Company” SHPK. Për arsye gabim njërëzor nga ana e Njesisë së Prokurimit është anuluar kjo procedurë, në vend të shpalljes së “Njoftimit të Fituesit”. Për sa më sipër, pretendimi i ankimuesit “Erisoni Company” SHPK qëndron. Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30 dhe 115 pika 1 dhe 3, 114 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik”, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, vendosi:

- 1. Pranimin e ankesës të paraqitur nga operatori ekonomik “Erisoni Company” SHPK për procedurën e prokurimit, me objekt “Loti 6, Blerje Tонера për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë” me fond të marrëveshjes kuadër 11,190,161 lekë pa TVSH, me Nr. REF-00456-07-07-2021.*
- 2. Personi përgjegjës për prokurimin të nxjerrë nga anulimi procedurën e prokurimit dhe shpallë, “Njoftimin e Fituesit”.*
- 3. Personi përgjegjës për prokurimin të njoftojë për vendimin e marrë ankimuesin, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi.*
- 4. Personi përgjegjës për prokurimin të njoftojë për vendimin e marrë Komisionin e Prokurimit Publik, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi, duke e shoqëruar me shpjegime dhe dokumentacionin përkatës”.*

Komisioni i Prokurimit Publik, pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimin e ankimuesit mbi vendimin e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me pretendimin e tij, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Me shkresën nr. 257/2 prot, datë 21.02.2022, protokolluar me tonën me nr. 272/3 prot., datë 23.02.2022 është dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, vendimi i autoritetit *kontraktor lidhur me trajtimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik “Erisoni Company” SHPK*, për procedurën e mësipërme të prokurimit, në të cilën **ka vendosur pranimin e ankesës** së bërë nga operatori ekonomik ankimues.

Konkretisht, autoriteti kontraktor në vendimin e sipërcituar ka arsyetuar si më poshtë:

“Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, në zbatim të vendimit të KPP, ka bërë rivlerësimin në sistemin e prokurimit elektronik si dhe në formë shkresore nëpërmjet procesverbalit nr. 3, “Për ri-vlerësimin e ofertave”, datë 17.01.2022 duke ri-kualifikuar operatorin ekonomik “Erisoni Company” SHPK. Për arsye gabimi njerëzor nga ana e Njesisë së Prokurimit është anuluar kjo procedurë, në vend të shpalljes së “Njoftimit të Fituesit”. Për sa më sipër, pretendimi i ankimuesit “Erisoni Company” SHPK qëndron. Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30 dhe 115 pika 1 dhe 3, 114 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik”, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, vendosi:

- 1. Pranimin e ankesës të paraqitur nga operatori ekonomik “Erisoni Company” SHPK për procedurën e prokurimit, me objekt “Loti 6, Blerje Tonera për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë” me fond të marrëveshjes kuadër 11,190,161 lekë pa TVSH, me Nr. REF-00456-07-07-2021.*
- 2. Personi përgjegjës për prokurimin të nxjerrë nga anulimi procedurën e prokurimit dhe shpallë, “Njoftimin e Fituesit”.*
- 3. Personi përgjegjës për prokurimin të njoftojë për vendimin e marrë ankimuesin, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi.*
- 4. Personi përgjegjës për prokurimin të njoftojë për vendimin e marrë Komisionin e Prokurimit Publik, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi, duke e shoqëruar me shpjegime dhe dokumentacionin përkatës”.*

II.1.2. Neni 30 i LPP parashikon shprehimisht se: *“Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarë për procedurat e tjera”.*

III.1.3. Neni 114 pika e ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i cili parashikon shprehimisht se: *1. Në rastet e ankesave për dokumentet e tenderit, autoriteti ose enti*

kontraktor duhet të shprehet në lidhje me ankesën e paraqitur brenda 5 ditëve nga momenti i konfirmimit të regjistrimit të saj nga Komisioni i Prokurimit Publik.

Në rastet e ankesave për vendimin e përzgjedhjes së kandidatëve pas fazës së parakualifikimit ose për procesin e vlerësimit të ofertave, autoriteti ose enti kontraktor duhet të shprehet për ankesën e paraqitur brenda 5 ditëve nga përfundimi i afatit kohor në dispozicion të operatorëve ekonomikë të interesuar, sipas parashikimeve në nenin 113 të këtij ligji, për paraqitjen e argumenteve të tyre.

2. Në rastin kur për shqyrtimin e ankesës autoriteti ose enti kontraktor ka nevojë të kryejë verifikime pranë organeve të tjera, afati i përcaktuar në pikën 1 të këtij neni ndërpritet dhe rifillon pasi të ketë siguruar informacionin e kërkuar. Në çdo rast, për pritjen e informacionit të kërkuar afati nuk duhet të tejkalojë 30 ditë.

Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të vërë menjëherë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik, ankuesin dhe operatorët ekonomikë të interesuar për zgjatjen e afatit.

3. Në përfundim të shqyrtimit të ankesës sipas parashikimeve në këtë nen, autoriteti ose enti kontraktor mund të vendosë:

- a) pranimin e plotë të ankesës;*
- b) pranimin e pjesshëm të ankesës;*
- c) refuzimin e ankesës.*

4. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor vë në dijeni për vendimin e marrë Komisionin e Prokurimit Publik, ankuesin, operatorët ekonomikë të interesuar brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi, duke e shoqëruar me shpjegimet dhe dokumentacionin përkatës.

5. Kundër vendimit të autoritetit ose entit kontraktor, operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën, kanë të drejtën të ankohen pranë Komisionit të Prokurimit Publik brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit nga autoriteti ose enti kontraktor, sipas pikës 4 të këtij neni.

6. Nëse operatorët ekonomikë të interesuar nuk kanë paraqitur ankesë sipas pikës 5 të këtij neni, ata nuk do të kenë të drejtë të paraqesin më pas një ankesë për veprimet e autoritetit ose entit kontraktor

III.1.4. *Neni 115 pika 1 dhe 3 e ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i cili parashikon shprehimisht se: Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë:*

a) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon shqyrtimin:

i. për pjesën e ankesës/pretendimeve që nuk janë pranuar;
ii. e ankesës/ankesave për pjesën që është pranuar, nëse ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre për këtë pjesë në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

b) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik do të vijojë shqyrtimin e ankesës, nëse ka ankesë nga

operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

c) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës.

3. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon plotësisht ankesën, Komisioni i Prokurimit Publik:

a) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga marrja e vendimit të dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor për këtë ankesë, nëse operatorët ekonomikë të interesuar nuk kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji;

b) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga përfundimi i afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të nenit 114 të këtij ligji, nëse operatorët ekonomikë të interesuar, që kanë paraqitur argumentet sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, nuk kanë ankimuar vendimin e dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor.

III.1.5. Nga shqyrtimi i informacionit të administruar me anë të shkresës nr. 257/2 prot., datë 21.02.2022, KPP konstaton, se autoriteti kontraktor Agjencia e Blerjeve të Përqendruara e ka pranuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues për procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi. Në këto kushte, bazuar në pikën 3 gërma “a” të nenit 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik do të mbyllë çështjen administrative për ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “*Erisoni Company*” SHPK.

III.2.. Nga shqyrtimi i veprimeve procedurale të kryera nga autoriteti kontraktor, Komisioni konstaton, se veprimet procedurale të autoritetit kontraktor, nuk janë kryer në përputhje të plotë me përcaktimet ligjore dhe nënligjore në fuqi për prokurimin publik, pasi me anë të shkresës nr. 257/2 prot., datë 21.02.2022, protokolluar me tonën nr. 272/3 prot., datë 23.02.2022, autoriteti kontraktor Agjencia e Blerjeve të Përqendruara, informon se gjatë zbatimit të vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 27/2022, datë 11.01.2022, për procedurën e prokurimit objekt-ankimi, KVO me anë të rivlerësimit të datës 17.01.2022, ka kualifikuar ofertën e paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “*Erisoni Company*” SHPK. Ndërsa, në datën 07.02.2022 autoriteti kontraktor ka bërë anulimin e kësaj procedure prokurimi për tjetër arsye dhe është publikuar në Buletinin e Njoftimeve Publike nr. 19, me datë 14.02.2022. Komisioni gjykon, se hapat proceduralë të ndjekur nga autoriteti kontraktor për anulimin e procedurës së prokurimit objekt-ankimi, nuk janë kryer sipas parashikimeve në nenin 98 “*Anulimi i një procedure prokurimi*”, të ligjit nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*”, ndaj bazuar në nenin 23 të ligjit nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, Komisioni i Prokurimit Publik, i propozon Agjencisë së Prokurimit Publik nisjen e hetimit administrativ në lidhje me këto veprime procedurale.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30 dhe 115 pika 1 dhe 3 e ligjit nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 261, datë 17.03.2010 “*Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik*”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “*Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*”, Nenit 4, te Vendimit te

Komisionit të Prokurimit Publik nr. 766/2021 datë 13.10.2021 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendosi

1. Të mbyllë çështjen mbi ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “*Erisoni Company*” SHPK, në procedurën e prokurimit **Loti 6** me Nr. REF-00456-07-07-2021 me objekt “*Blerje Tonerë për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë*” me fond limit të 11,190,161 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 15.10.2021 nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Blerjeve të Përqendruara.
 2. Autoriteti kontraktor **nuk lejohet** të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
 3. T’i propozojë Agjencisë së Prokurimit Publik nisjen e hetimit administrativ për konstatimet e mësipërme, si edhe të dërgohet pranë APP-së kopje e materialeve të administruara në shqyrtimin administrativ nr. 272 prot., datë 14.02.2022.
 4. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “*Erisoni Company*” SHPK.
 5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
 6. Kopje e këtij vendimi ti dërgohet Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Kryetar
Jonaïd Myzyri